



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ____ / ____ / 2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)
OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje Fadrome me kove”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
44510000-8- mjete, 34140000-0 - automjete te renda.

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 8.333.333 (tetemiljon e treqind e tridhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre) **leke pa TVSH.**

I mbajtur sot me date **25.03.2026** ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, autoriteti kontrator Agjensia sherbimeve publike Rurale Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion

burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Kriteret (a) vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar.

2.2.2 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2025 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore).

Kriteri 2.2.1 është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nenit 43 dhe nenit 55 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Kriteri 2.2.2 është vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e perves se meparshme te realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Kriteri 2.3.1 është vendosur referuar nenit 55 pika 4 gërma "b" te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese certifikaten e vlefshme:

- **SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit te Cilesise” ose ekuivalente, e vlefshme**

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Kriteri 2.3.2 është vendosur ne perputhje me Nenin 40 pika 6 germa c te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar ne nenin 44 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter është vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikaten e menaxhimit te cilesise gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te AK qe ky OE do te ofertoje produkte te certifikuar te nje cilesie te mire e ne perputhje me standartet nderkombetare te cilesise.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Ne rast se do te

paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet te provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit te autorizuar.

Secili nga dokumentat duhet te jete i vlefshem, nese eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete i perkthyer ne shqip dhe i noterizuar, si dhe te permbaje te dhena te plota te prodhuesit ose distributorit te autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

Kërkesa 2.3.3 bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalog/katalogje të prodhuesit **ose** fragmente të katalogut/eve te prodhuesit **ose** skede teknike te prodhuesit, qe permbajne te dhena dhe specifikime teknike te ketyre mallrave objekt prokurimi, te cilat duhet te jene ne perputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor, per mallrat objekt prokurimi. *[Nese materiali/et te cilat do te paraqiten per te permbushur kriterin e mesiperm jane ne gjuhe te huaj, ato duhet te perkthehen ne shqip per pjesen e te dhenave teknike te kerkuara si dhe te noterizuara].*

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.5 Operatori Ekonomik pjesemarres duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallrat e ofertuara, në të cilën të jenë te përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike te filloje nga data e marrjes ne dorezim te mallrave nga autoriteti kontraktor dhe do te zgjasi 12 muaj ose 1000 ore pune.

Kërkesa e mësipërme 2.3.5. është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 8 gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e

ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dakortësinë për të përmbushur kontratën konform kërkesave të Autoritetit Kontraktor

2.3.6. Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të garancisë, operatori ekonomik duhet të ketë dhe të paraqes listën e serviseve në pronësi, me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi të deklaruar referuar tabelës sa më poshtë:

Nr.	Vendndodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim
Etj		Pronesi/qira/perdorim

Për ambjentet e servisit operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Kontratën e qerasë/huapërdorjes/ ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Kriteri 2.3.6 është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se me dorëzimin e mjeteve objekt i procedurës së prokurimit, (për ato mjete që aplikohet), detyrimsht do të mbulojë me shpenzimet e tij të gjitha pagesat në lidhje me:

- Tarifen e kontrollit fizik
- Tarifen e regjistrimit (targat)
- Taksat vjetore
- Pagesën për kontrollin teknik (në rastet kur nuk përjashtohet nga DPSHTRR)
- Pagesat për TPL
- Si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësi, etj) .

Kriteri 2.3.7 është bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të*

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.3.8 Operatori duhet të disponoj Licenca me kod VII.3.B. 1 ose VII.3.B. 2 sipas ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitim të mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktitura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në legjislacionin e prokurimit dhe atë të fushës së objektit që po prokurohet perkatesisht: në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu kjo kërkesë është bazuar dhe në UDHËZIM Nr. 1545, datë 29.3.2016 “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi” veprimtaria e shitblerjeve të mjeteve u lejohe vetëm subjekteve të regjistruara në DPSHTR. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentim teknik : specifikimet janë hartuar duke u bazuar në natyrën e punës që do të mbulojë mjeti duke patur parasysh terrenin e vështir, levizjet me distanca të largëta dhe tipologjinë e rrugëve rurale ku do të punohet. Motorri është konceptuar si ekonomik për të ulur koston e levizjes së mjetit. Kërkesa për mjet të ri është bazuar në studimin e kostove të mirëmbajtjes që mund të kursejë AK.

Njësia e prokurimit

Ilda Tavanxhiu

Drilona Mema

Xhensila Cullhaj